



جائزة

Çmimet AIITC 2008





“Çmimi AIITC” organizohet çdo vit nga Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam.
Ai përfshin tri kategori:

- 1- Libri më i mirë i vitit në fushën e shkencës dhe të kulturës islame
- 2- Peizazhi më i bukur në penelat e piktorëve shqiptarë
- 3- Krijimi më i arrirë nga moshat e reja në prozë ose poezi me temë
“E bukura në jetë dhe në shpirt”

Synimi i këtij çmimi është që të stimulojë të gjithë studiuësit dhe artistët e moshave të ndryshme, brenda dhe jashtë territoreve shqiptare, që kanë dhënë dhe japin ndihmesën e tyre në fushën e shkencës, artit dhe kulturës islame.



Çmimi AIITC 2008

Në fushën e shkencës, artit dhe kulturës islame

Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC), një qendër e njohur tashmë për kontributet e saj në fushën e shkencës, artit dhe kulturës, botimeve të ndryshme dhe aktiviteteve me karakter akademik, merr përsipër dhënien e disa çmimeve vlerësuese në këto fusha.

Efektet e këtyre çmimeve do të kontribuojnë në përhapjen e dijeve, zhvillimin e kulturës dhe arteve ndër shqiptarë.

“Çmimi AIITC” në fushën e shkencës, artit dhe kulturës islame është i përvitshëm dhe përfshin tre kategori:

1. *Libri më i mirë i vitit në gjuhën shqipe, që trajton tema në fushën e shkencës, artit dhe kulturës islame.*

2. *Peizazhi më i bukur në penelat e piktorëve shqiptarë*

3. *Krijimi më i arrirë nga moshat e reja në prozë ose poezi me temë “E bukura në jetë dhe në shpirt”*

Komisioni i Çmimeve AIITC për vitin 2008 fton: Akademi, institute, universitete, qendra kërkimi, institucione të larta studimore dhe individë brenda trojeve shqiptare dhe në diasporë, për të marrë pjesë në konkursin e vitit 2008.

